



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.07.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me akademikun Artan Fuga për diskutimin e projektligjit “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, propozim i një grupi deputetësh (*komision përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Klajdi Qama, Selami Jenishehri.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

Deputetë të grupit propozues:

Senida Mesi.

I ftuar:

Artan Fuga – akademik.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri – Përsëndetje!

Në rendin e ditës së sotme është parashikuar seanca dëgjimore me akademikun Artan Fuga për diskutimin e projektligjit “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, propozim i një grupi deputetësh.

I nderuar profesor, mirë se erdhët në mbledhjen e komisionit!

Ju lutem, na jepni mendimet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me projektligjin për Akademinë e Shkencave. Si mendoni ju, cilat janë risitë, të metat apo defektet e këtij projektligji?

Fjala për ju.

Artan Fuga – Faleminderit, zonja kryetare!

Nëse më lejoni t’ju pyes, a ka ndonjë hapësirë kohe që duhet të respektoj?

Fatjona Dhimitri – Profesor, keni të gjithë kohën në dispozicion.

Artan Fuga – Unë do të mundohem të jem sa më konciz.

Faleminderit për ftesën që më keni bërë për të ardhur në këtë vend të lartë, që, sigurisht, është një privilegj dhe do të mundohem që kohën ta shfrytëzoj sa më mirë.

Është e rrallë që deputetët të dëgjojnë një njeri, por të jem i singertë nuk e konsideroj si privilegj në këtë kuptim, sepse në këtë proces jam ftuar zyrtarisht nga ekzekutivi i sotëm të marr pjesë personalisht, për shkak të pozicionit që kam mbajtur, prandaj po bëj detyrën time deri në fund.

Ju falënderoj për praninë tuaj dhe shpresoj të keni durimin të më dëgjoni me vëmendje!

Gjithashtu, falënderoj edhe mediet që më japin mundësi të komunikoj edhe me një komunitet më të gjerë universitar dhe shkencor, një transparencë kjo shumë e rëndësishme.

Unë jam këtu pas një censurimi 10-vjeçar nga një institucion që në vlerat e veta duhet të kishte respektin për diversitetin e mendimit dhe të mendimit ndryshe. Pra, unë vij pas 10 vjetëve përpjekje për reformimin e Akademisë së Shkencave.

Sot dua të them disa gjëra që për mua, në peshën time për aq sa mbaj unë, janë të rënda. Shpresoj të dëgjohem dhe të mos ndërpritem, siç më ka ndodhur në dhjetëra raste. Kjo në një moment të caktuar më bën të dal jashtë institucionit dhe jashtë etikës së akademikut dhe t’i

drejtohem publikut nëpërmjet medies, që në kuptimin tim nuk është etika e akademikut për aq kohë sa institucioni funksionon.

Nuk kam asnjë interes personal në këtë që po them. Të gjithë e deklarojnë mungesën e interesit personal, por dua të vërtetoj se kam bërë një deklaratë publike, që nuk do të kandidoja për vendin e kryetarit të Akademisë së Shkencave, për sa kohë që kisha marrë përsipër një perspektivë rinovimi dhe reformimi të saj.

Për të gjithë punën time nuk jam paguar asnjë lek, as për broshurën dhe për asgjë, jo se jam filantrop, por e kam konsideruar se unë e marr një shpërblim si akademik, prandaj nuk kam nevojë të marr të tjera. Fatkeqësisht, nuk ka qenë kështu me grupin tjetër, nuk e di se sa janë paguar, por kjo është një çështje etike e tyre dhe e gjen vetë Akademia nëse ka pasur mundësi të paguajë dy herë për të njëjtën punë akademikët që merren me reformimin apo jo. Unë nuk e kam pranuar.

Nuk kam asnjë interes personal dhe kam thënë se, nëse do ta konsideroj veten që nuk jam në përputhje me disa vendimmarrje, do të jap dorëheqjen nga Akademia e Shkencave, sepse nuk më intereson të jem në një vend ku parimet dhe vlerat që unë i konsideroj se nuk janë të mijat, por të shoqërisë, nuk respektohen.

Me mua mund të vinin edhe dhjetëra profesorë të tjerë, por, siç e diskutuam edhe me zonjën Dhimitri, kjo mund të kishte nevojë për procedura shtesë, prandaj menduam ta bëjmë thjesht.

Fjala ime do të ketë 6 pika. E para është procedura. Unë gjykoj se projektligji që ka ardhur nga grupi i deputetëve iniciatorë, fatkeqësisht nuk respekton vlerat e parlamentarizmit shqiptar, vlerat e respektit të komunitetit shkencor, të cilat janë në themel të aspektit normativ, por edhe të atij etik.

E dyta, këto defekte procedurale shumë të rënda janë të lidhura me faktin se projektligji i paraqitur, i cili në përmbajtje nuk është i grupit iniciator, por është i dikujt tjetër, është një projektligj i dështuar, si frymë, si parim dhe si mision. Këtë do të përpiqem t’jua provoj.

Së treti, unë them se nuk është e rastit, sepse Akademia e Shkencave e ka provuar se nuk e bën dot këtë reformim. Akademia është drejtuar në atë mënyrë dhe ka ardhur në ditët e sotme si një institucion që nuk përmbush asnjë nga pritshmëritë e publikut apo të komunitetit shkencor. Pra, siç duket, ka nevojë për reformim, e ka të vështirë të reformojë vetveten, sepse po ta kishte mundësinë, ndoshta do ta kishte bërë.

Së katërti, unë nuk kam qëndruar vetëm te kritika në parim apo nën për nën, pa ju marrë kohën tuaj shumë të vyer, por kam bërë edhe një propozim në një projekt, të cilin nuk e konsideroj as perfekt dhe as si ai që do ta mbyllë procesin, por si një pistë të re për t’u diskutuar.

Unë do të jap prova në kundërshtim edhe me ndonjë gjë që besoj se e keni dëgjuar, se asnjë mendim, ide apo propozim që kam bërë nuk është marrë parasysh nga grupi i punës apo nga grupi i deputetëve iniciatorë për projektligjin që ka ardhur.

Deklaroj me përgjegjësi të plotë se, nëse do të gjeni vetëm një element që është marrë parasysh, unë do të tërhiqem në tërë linjën, aq më shumë kur kam dëgjuar që më atribuohen gjëra të cilat unë luftoj për t'u hequr nga projektligji, si, për shembull, të qenurit e akademikëve në mënyrë *ad-hoc* anëtarë të senateve të IAL-ve të Shqipërisë.

Këtu ka njerëz që i respektoj dhe e dinë që ky nen është nonsens edhe për një universitar, pra është një gjë e papranueshme për arsye se, siç thotë edhe mendimi që ka dhënë qeveria disa ditë më përpara, bie në kundërshtim total me të gjitha ligjet në fuqi, që veprojnë në Republikën e Shqipërisë.

E pesta, ka të bëjë me atë se çfarë unë mendoj për procesin ligjvënës sot, jo për punën tuaj, sepse unë nuk guxoj të futem në kompetencat tuaja, por për të parë disa kundërshti, të cilat e bëjnë procesin ligjvënës të papjekur dhe shumë larg për të ardhur përpara vëmendjes suaj të lartë dhe për të diskutuar. Këtë do të përpiqem t'jua provoj.

E fundit, ka të bëjë me atë çfarë unë propozoj.

Të fillojmë me çështjen e parë, anën procedurale. Më lejoni të them se çështja e Akademisë dhe reformimit të saj është bërë publike fillimisht nga ana ime, këtu ka njerëz që e dinë, por edhe në medie është bërë publike, prandaj nuk ka nevojë për prova. Unë e kam hapur këtë problem, jo se jam më i mençur se të tjerët, por sepse kjo është detyra ime. Unë jam në atë Akademi dhe paguhem nga taksapaguesit, prandaj mendoj se duhet të kishte shkuar në nivelin e duhur.

Që nga viti 2008 brenda Akademisë ka dokumente që tregojnë se jam përpjekur hallkë pas hallke në seksion, në këshillin ekzekutiv dhe me kolegë të shtyj përpara një reformim. Por ishte e pamundur, sepse të gjitha propozimet e mia janë censuruar, për të mos ardhur asnjëherë në asamble.

Në vitin 2017 ndodhi një ngjarje shumë e shëmtuar. U bënë zgjedhjet në Akademinë e Shkencave me rezultatin 100%, zgjedhje që unë i konsiderova farsë, për arsye të cilat nuk ka nevojë t'i them. Mbas kësaj, problemi u rimor nga kreu i ekzekutivit, Kryeministri, zoti Edi Rama, i cili më 22 nëntor të vitit 2017 ka thënë, ju lutem, dëgjojeni këtë fjalë: "Pyetja shumë e thjeshtë që ngrihet është: çfarë duam ne nga kjo Akademi dhe çfarë i shërben vendit të ketë?"

Si rezultat i rithemelimit të këtij institucioni, kërkon rithemelim. Akademia si e tillë nuk është institucion që bën kërkim shkencor, siç ju ka ardhur në projektligj, por është kuvendi i atyre që e bëjnë shkencën në sektorët përkatës dhe që garantojnë autoritetin e një gjykate

llogarie, po themi, të gjithë jetës akademike dhe shkencore, ku ndikimi mbi autoritetet dhe opinionin vjen si rezultat i cilësisë së përfaqësimit në këtë kuvend të shkencës.

1. Rithemelim.
2. Nuk është institucion kërkimi shkencor.
3. Akademikët e bëjnë kërkimin shkencor në institucionet përkatëse.

Kjo është strategjia e qeverisë.

Ju e dini se nuk jam njeri që e kursej qeverinë, kur mendoj se i bëj mirë të mirës publike, por në këtë rast deputetëve të shumicës u them se kjo është strategjia që është deklaruar nga ekzekutivi që ju përfaqësoni dhe legjitimoni.

Unë shikoj se në atë projektligj asnjëra nga ato kuota nuk është arritur, por këtë do ta shohim pak më vonë, aq më pak të flasim për rithemelim.

Në vazhdim të kësaj strategjie të qeverisë, ish-ministrja e Arsimit, zonja Lindita Nikolla, të cilës i shpreh respektin e mirënjohjen time dhe i kërkoj falje për shqetësimet që i kam shkaktuar në mënyrë personale, por kanë qenë për arsye pune, me urdhër nr. 29, datë 16 janar të viti 2018, ngre grupin e punës të përbërë nga 7 persona, të cilët përfaqësojnë një vijë dhe janë dakord me njeri-tjetrin. Unë e pyeta se si është e mundur që në këtë grup pune të mos jetë edhe zëri alternativ, pra të isha edhe unë, jo si Artan, por si një zë alternativ? Megjithatë, procesi ishte në fillim dhe do të ecte. Unë e kam diskutuar edhe me zonjën Lindita, se ajo që vërej është se në këtë grup nuk ka të jashtëm, por janë të gjithë anëtarë të Akademisë. Kur një institucion është i sëmurë, parimi është se duhet të dalë një komunitet me vlera shkencore të jashtëzakonshme, të cilët Shqipëria i ka sot, por asnjë nga ky komunitet nuk është atje, por janë vetëm anëtarë të Akademisë së Shkencave, madje një pjesë janë administratorë. Unë që këtu thashë se ky proces nuk mund të mbyllet, sepse ka rrezik të na prodhojë një projektligj të dështuar dhe ashtu ndodhi.

Ata janë akademikë të nderuar në fushat e tyre, por ka një problem se asnjëri prej tyre nuk është specialist në fushën e teorisë së shkencës; asnjëri nuk është specialist në fushën e sociologjisë së shkencës; asnjëri nuk është specialist në logjikën e shkencës dhe as në epistemologji.

Nuk dua të merrem me citime filozofësh, por është shumë e drejtë thënia: “Fizika studion objektin e vet, por fizika nuk e studion fizikën. Biologjia studion objektin e vet të studimit, por nuk studion biologjinë”.

Gustave Le Bon thotë: “Kur akademikët dalin nga profesioni i tyre, ata kthehen në turmë si të gjithë të tjerët”. Pra, ne jemi në turmë si të gjithë të tjerët në momentin kur dalim nga fusha e kompetencave.

Unë pyes: cila është kompetenca e këtij grupi prej 7 vetash për të bërë analizën e shkencës dhe reflektimin mbi shkencën? Për këtë kisha dyshime dhe i kam shprehur, por gjithmonë kam pritur, sepse janë akademikë; sigurisht nuk janë të specializuar në atë fushë, por kanë eksperiencën e punës shkencore, në formën e një përvoje të përditshme.

Së bashku me zonjën ministre të asaj kohe, kemi rënë dakord për një kalendar për të ballafaquar idetë për projektligjin që sot keni. Ky kalendar përfaqëson dy vlera të mëdha, të cilat ishin: e para, do të ngrihej një juri e madhe e përbërë nga personalitete shkencore të jashtme neutral, që do të gjykonin platformat.

E dyta, do të bëheshin ballafaqime në Ministrinë e Arsimit mes dy bazave apo disa bazave të platformave të ndryshme dhe në medie. Por asnjëra nga këto nuk u bë, sepse ndodhën ngjarjet e lëvizjeve studentore dhe zonja Lindita iku. Me sa di unë, ky ishte një vendim ministror dhe zyrtar, por në momentin që zonja ministre iku, e gjitha kjo ra në ujë.

Unë kam të drejtë të pyes: a jam në një shtet ku vendimet që merren në një ministri vazhdojnë përtej ndryshimit të personave që janë në krye të institucioneve apo me ndërrimin e ministrit të gjithë urdhrat, vendimet që merren, bien? Nuk kam akoma një vendim të kundërt nga ana e Ministrisë së Arsimit. Unë do ta pranoja nëse do të kishte një vendim ku të thoshte: “Urdhri i zonjës Lindita Nikolla anulohet”, por nuk ka. Unë pres, sepse dua një shtet ligjor dhe rregulla në shtetin tim, sepse u besoj atyre.

Në Akademinë e Shkencave në datën 22 dhjetor të vitit 2017, në shkresën me numër protokolli nr. 529, merret vendimi për kalendarin e reformës së Akademisë. Nuk po e lexoj, por do t’jua vë në dispozicion. Aty thuhet se do të bëhej: hartimi i draftligjit, hartimi i draftit të VKM-së, hartimi i draftit të statutit të Akademisë së Shkencave dhe hartimi i draftit të Kodit Akademik të sjelljes, të cilat do të bënin këtë reformë. Ju lutem, më thoni se cilat nga këto drafte keni, me përjashtim të projektligjit? Keni vetëm një dokument, ndërsa pesë të tjerat që janë në vendimin e asamblesë nuk i keni. Si mund të gjykohet për reformimin e një institucioni në momentin kur nga 6 dokumente që duhet të prodhonte, ky grup reforme ka prodhuar vetëm 1?

Mbi të gjitha, zonjës Englantina Gjermani, të cilën do të doja të ishte këtu, i jam drejtuar me pyetjet: kur keni vajtur në Ministrinë e Arsimit dhe keni marrë këtë projektligj, të cilin e keni quajtur si të tuajin, a keni bërë studime? A e keni të mbështetur në studime? A keni një relacion, ku studiohet me themel gjendja e Akademisë së Shkencave? A keni komunikuar me komunitetin? Gjithashtu, i bëra edhe një pyetje jomodeste: a e ke parë platformën time?

Më është përgjigjur: “Nuk e di se ka një platformë alternative, sepse nuk më ka thënë njeri”.

Ju do të thoshit: “Po ju a keni një studim?”, po e kam një studim dhe e kam botuar. Po të doni një herë tjetër mund t’ua paraqes në *power point*, pra jam në dispozicionin tuaj.

20% e buxhetit të botimeve të Akademisë së Shkencave shkojnë për 7 vetë që janë akademikë të punësuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Unë ju falënderoj për të gjithë shpjegimet që po bëni!

Vërtet mund të keni kohë për përshkrimin e situatës, por ju kërkoj që zgjatja juaj më e madhe të ishte te platforma juaj dhe jo te konteksti i platformës. Ne e kuptuam që ka një urdhër për të bërë një sërë dokumentesh për kërkime shkencore, por në këtë moment neve na duhet një opinion juaj për platformën. Ne e kemi marrë platformën tuaj dhe e kemi studiuar, kemi marrë edhe opinionet që kanë rektoratet në Republikën e Shqipërisë, gjithashtu kemi parë ndryshimet që ka platforma juaj me projektligjin që është propozuar nga nismëtarët. Në këtë moment ne duam që të na jepni një informacion më të plotë për platformën tuaj, sepse ajo na shërben për punën tonë. Ne e kuptojmë kontekstin, por do të ishte mirë ta ndanit kohën, duke na vënë në dispozicion ide për platformën.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zonja nënkryetare!

Profesorin e nderuar ne e kemi të ftuar për herë të parë në komision, për të diskutuar për mendimet alternative për projektligjin, pra për këtë projektligj. Prandaj, ju lutem, kërkoj edhe mirëkuptimin tuaj që ta dëgjojmë profesorin deri në fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta dëgjojmë deri në fund atë që ka sjellë për këtë komision. Ju lutem, kini durim ta dëgjoni.

Milva Ekonomi – Sa për dijeni, profesori ka qenë këtu edhe herë të tjera, pra nuk është hera e parë që e thërrasim.

Fatjona Dhimitri – Po flas për këtë projektligj.

Milva Ekonomi – Zonja kryetare, ne po kërkojmë ta respektojmë profesorin, por edhe veten. Duke respektuar profesorin, u japim të gjithëve mundësinë...

Fatjona Dhimitri – A kërkuam mendime alternative?

Milva Ekonomi – Po, ne po kërkojmë që të flasë për mendimet alternative. Faleminderit për kontekstin, por na ndihmoni duke na shpjeguar platformën.

Fatjona Dhimitri – Ndoshta mendimet alternative të profesorit prekin maxhorancën. Ju lutem, vazhdoni.

Milva Ekonomi – Maxhoranca nuk preket nga mendimet alternative, sepse ne kemi kuorumin. Ne duam të dëgjojmë profesorin...

Fatjona Dhimitri – Përderisa nuk po arrijmë një mirëkuptim...

Milva Ekonomi – Më lini të mbaroj, sepse unë nuk ju ndërpreva fjalën. Një nga gjërat që duhet të keni parasysh është që...

Fatjona Dhimitri – Po, zoti Valter.

Halit Valteri – Milva, të kërkoj ndjesë...

Milva Ekonomi – Nuk mund të ma ndërpresësh fjalën mua, se e kam marrë për procedurë. Të gjithë duhet të kemi parasysh se vendimin për ta thirrur profesorin në këtë dëgjese e kemi marrë përpara se të bashkoheshit ju me komisionin.

E para, sepse mendojmë që platforma e profesorit është e rëndësishme.

E dyta, vendimi për këtë dëgjese është marrë përpara se Këshilli i Ministrave të kthente përgjigje për platformën e ardhur nga deputetët.

E treta, kemi shumë nevojë ta dëgjojmë profesorin. Për këto arsye është kuorumi i Partisë Socialiste këtu. Kjo është diçka që duhet ta kemi parasysh të gjithë. Po kërkojmë të gjykojmë me objektivitet këtë projektligj që kemi përpara.

Halit Valteri - Të njëjtën gjë doja të thosha edhe unë, por thjesht nuk ...

Po flasim për Akademinë e Shkencave, prandaj të mos bëjmë të njëjtin gabim që po bën Rama, që ta trajtojmë politikisht, maxhorancë - opozitë.

Profesorin kemi të drejtë ta dëgjojmë të gjithë, por, me gjithë respektin që kam për të, sepse e ndjek, dua t'i them diçka. Ju dëgjova të thoshit se ia keni thënë Eglantina Gjermanit, Lindita Nikollës, Halitit, Fadilit. Nuk keni nevojë t'ia thoni askujt, sepse i vetmi njeri që "ia hedh trutë" Ramës për të marrë këto vendime është nipi juaj, zotëri. Fol me nipin, mbushi mendjen dhe hajde na sill platformën!

Zoti Fuga, edhe njëherë, ju jap të drejtë njëqind përqind për çdo gjë që thoni, por ju e keni problemin familjar dhe jo te Komisioni i Medies.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Halit, të lutem, të mos kalojmë në përvetësime të tilla!

Fjalën e ka zoti Fuga.

Mund të vazhdoni, profesor!

Ju lutem, kini durim ta dëgjojmë deri në fund profesorin! Pjesëmarrja e trupës së rektoratit, e profesorëve dhe e katedrës na nderon këtu.

Profesor, vazhdoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në seancën e sotme kemi pasur profesorë, por edhe profesor Fugën. Kështu që, po flas

...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Këtë seancë e kemi të specifikuar vetëm për zotin Fuga.

Fatjona Dhimitri – Atëherë, dëgjojmë zotin Fuga.

Milva Ekonomi – Atë po ju bëj me dije. Ta dëgjojmë për platformën, sepse e kemi thirrur në mënyrë të posaçme dhe e respektojmë mendimin e zotit Fuga.

Fatjona Dhimitri – Vazhdoni, profesor.

Artan Fuga – Ndërkohë unë do ta kisha mbaruar pjesën e parë. Dua t’i them zotit deputet që unë nuk i ngatërroj problemet familjare me problemet e punës, të shtetit dhe të funksioneve, ky është parimi i parë, në të kundërt do të ishte një formë korrupsioni pasiv.

Mund të vazhdoj tani?

Fatjona Dhimitri – Po, profesor, ju lutem, vazhdoni!

Artan Fuga – Ju faleminderit!

Në vend që, sipas këtij kalendarit të Akademisë së Shkencave, të vinin draftet, juve, përpara sesa t’ju vinte drafti, ju ka ardhur fakti që Akademia e Shkencave ka bërë zgjedhje. Po të shikoni vendimin tonë të datës 22 dhjetor, nuk thuhet që për reformim të bëhen zgjedhje. Do të thotë që Akademia e Shkencave e zgjidh problemin se kush e kontrollon për 4 vjetët e ardhshëm, pastaj thotë, zonja dhe zotërinj deputetë, na reformoni, por ne do të vazhdojmë të zgjidhemi sipas metodës së vjetër.

Nuk jam duke folur për kontekstin, e dashur Milva, por për procedurën. Unë mendoj, mbase në kulturën time juridike e kam gabim, se deputeti gjykon për përmbajtjen dhe për procedurën. Unë besoj se ju keni nevojë për të dyja. Kërkoj ndjesë dhe prandaj kërkoja minutat, por unë nuk do të abuzoj me minutat e mia.

Duke parë ngecjen e reformës, vitin e kaluar, me rastin përvjetorit dhe ceremonisë së dhënies së çmimeve për Skënderbeun, zoti Kryeministër shkoi në Akademinë e Shkencave. Ndërkohë, ngaqë isha censuruar dhe nuk mund t’ia jepja më askujt propozimet e mia, unë jam i detyruar t’ju them, zoti deputet, ku kam vajtur, sepse një nga akuzat që më është bërë mua është “ti i mban gjërat për vete”. Jo, nuk i mbaj gjërat për vete. Kam folur me të gjithë aktorët. Vetëm pak durim për 10 vjetët e punës sime, ju lutem, vetëm për këtë gjë!

Zoti Rama thotë: “Këtë reformë, nën drejtimin e profesor Gjinishit, por edhe përballë një platforme alternative të propozuar nga profesor Artan Fuga, nëse do të qëndronim strikt proceduralisht në raport me tekstin e reformës, atëherë do të duhej të falënderonim profesor Artan Fugën për kontributin e tij, do të ecnim përpara pa u ndalur asnjë sekondë me tekstin e

sjellë nga grupi i punës. Mirëpo, - thotë ai, - ajo që na duket më e arsyeshme është që të ndalemi një sekondë dhe të nxisim një ballafaqim mes dy alternativave, pavarësisht se njëra është e veshur me petkun zyrtar, kurse tjetra vjen si kontribut nga një anëtar i Akademisë. Mbase platforma alternative ka gjëra për t'u marrë në konsideratë, mbase platforma alternative është edhe më e mirë se ajo e grupit të punës". Pse e them këtë? E them, sepse në atë moment jam thirrur nga ministria e asaj kohe, e cila më ka thënë: "Zoti Fuga, ka një kërkesë për të rifutur platformën tuaj, sepse ne duhet të diskutojmë. Apo jo zonja Nikolla? Pikërisht në atë moment unë bëj përpjekjen që platforma ime të rishkojë edhe një herë në Akademi. I them zonjës Lindita, të lutem, si do të bëjmë!?"

Me shkresën e protokollit nr. 173, zonja Milva, sekretari Shkencor i Akademisë së Shkencave, Vasil Tole, thotë: "Në përgjigje të kërkesës së zonjës ministre, më 27 prill 2018, në mbledhjen e rregullt të Asamblesë për aprovimin e raportit vjetor dhe programit të punës për vitin 2018, akademiku Artan Fuga ka ngritur pyetjen se pse nuk mbledhet Asambleja për të shqyrtuar një variant të tij", ndonëse përpara kësaj mbledhjeje nuk ka pasur asnjëlloj projektligji të paraqitur dhe nuk pranon ta marrë në shqyrtim.

Më pas zonja ministre jep dëshminë e vet, ku thuhet: "Përshëndetje, të nderuar zotërinj! Pasi zoti Kryeministër kërkoi debat gjithëpërfshirës, kam kërkuar që zoti Fuga të japë platformën e tij në ministri dhe jo në Akademinë e Shkencave, sepse Akademia e Shkencave nuk pranon ta marrë në shqyrtim". Besoj se ju kujtohet.

Në momentin kur Ministria e Arsimit ishte duke punuar me dy platforma, kishte marrë mendimin e komunitetit shkencor të vendit dhe po e shqyrtonte, si dhe po shkonte në fund të procesit, grupi i deputetëve merr projektligjin, merr njërën platformë dhe injoron tjetrën, dhe jua paraqet juve. I kujt është drafti që ju keni përpara? I Akademisë së Shkencave apo i Ministrisë së Arsimit, sepse Ministria e Arsimit ka thënë që pavarësisht se ne kishim një përfaqësues atje, rezultati dhe ndikimi ynë mbi këtë projektligj është zero, apo është i grupit iniciator? Në qoftë se është i një autori apo i një autori tjetër, procedura ndryshon. Pse u ndërpre puna që po bënte Ministria e Arsimit? Këtu është edhe zoti Redi Shtino, i cili ka punuar për këtë projektligj me përkushtim dhe aq sa ka mundur, të cilin, me shumë respekt, dua ta pyes: A keni ndonjë ide pse jua ndërprejnë punën? Deklaruat ju që nuk e bëni dot apo erdhën dhe jua morën, duke thënë që ne injorojmë strategjinë e qeverisë, urdhrin e ministres, gjithë procedurën dhe tani ne do të vazhdomë me një gjë tjetër?

Në fund, nga ana procedurale, për herë të dytë Akademia e Shkencave bën zgjedhje, të cilat janë të paligjshme. Pse? Sepse kandidon dikush që është kryetar partie, që sipas nenit 6, pikës 1, të ligjit në fuqi, është e ndaluar. Do të vazhdojmë të dëgjojmë një Akademi ku janë

bërë zgjedhje të paligjshme? Problemi fillon këtu dhe jo te përmbajtja. Përmbajtja ka lidhje me të gjitha aksionet që bëhen.

Çështja e dytë, tani do të vij tek ajo që ju kërkoni, zonja Milva, përmbajtja e projektligjit që ju keni në tavolinë, paraqitur nga grupi iniciator, por që në fakt është projektligji që ka bërë grupi i ngritur nga Ministria e Arsimit, ka probleme të mëdha në strukturë dhe në formulimin e neneve. Mua më ka rënë si një gjë e rëndë kur kam parë mendimin e dhënë nga Këshilli i Ministrave gjashtë ditë përpara, i cili thotë gjëra që i kemi diskutuar para 2 vjetëve.

Ky ligj është në kundërshtim me ligjin për arsimin e lartë dhe shkencën në Republikën e Shqipërisë të paktën në dhjetë pika. Çfarë do të bëjmë ne?

Neni 3.

“Akademia është institucioni publik më i lartë.” Ç’do të thotë “më i lartë”? I kujt? Ne nuk kemi hierarki në kërkimin shkencor. Ne kemi diversitet, autonomi, kurse më i lartë apo më i ulët është një sistem piramidal.

Akademia, thotë, do të quhet Asamble. Më tej thotë që Akademia, përveç Asamblesë, ka edhe bibliotekë, entin e botimit, komisionet. Me të drejtë, nga ana logjike e definicionit juridik, qeveria i thotë na e përcakto pak si është e mundur që Akademia është Asamble. Unë nuk e di nëse këtu midis nesh ka ndonjë semantolog, sepse unë nuk jam, por di që ose janë sinonime, ose janë e njëjta gjë. Nëse janë e njëjta gjë, përdoret e njëjta fjalë. Nuk ka rëndësi kjo.

Pika 2: “Akademia është institucion autonom në fushën e kërkimit.” Akademia e Shkencave bëka kërkim! Nga ndryshon Akademia nga një institut kërkimi shkencor? Si përputhet kjo me platformën e shprehur nga Kryeministri, i cili thotë se Akademia nuk është vendi ku bëhet kërkimi shkencor? Si është e mundur që në Akademi ne paskemi një agjenci të kërkimit shkencor, ku aty një është biolog, një filozof, një sociolog, një inxhinier, një fizikant? Ku janë parë këto institucione të kërkimit shkencor me përbërje *eteroklite*, që nuk ka një të vetëm në Shqipëri? Prandaj dështon dhe vazhdon të kërkojë dështimin e vetë ajo Akademi. Nuk është e rastit. Pse? Sepse kjo reformë është bërë mbi bazën e ruajtjes së interesave tona, që jemi brenda atje. Për mendimin tim, nuk bëhet kështu reforma.

Neni 3, pika 3: “Akademia, si person juridik, është trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve”. Njeriu, me logjikë dhe kulturë më minimale juridike, di të dallojë se personi juridik nuk është person fizik, nuk është trup, nuk është materie. Nuk jemi ne, njerëzit që jemi atje, personi juridik, por është institucioni.

Për çdo nen mund të rrimë nga gjysmë ore për të vënë duart në kokë se si është e mundur. Kjo vjen sepse në grupin e punës nuk keni asnjë jurist, zonja Lindita. Ju nuk keni faj, sepse ata aty i kishin juristët dhe mund t'i merrnin.

Neni 4. Përbërja e Akademisë.

Akademia thuhet se është Asambleja, kurse tani thotë që organet e Akademisë janë: Asambleja, Kryetari, Kryesia. Po aty, thuhet, Biblioteka. Unë kam bërë një studim. Për çfarë i duhet Akademisë së Shkencave biblioteka, kur 100 metra në vijë ajrore ka Bibliotekën Kombëtare, ku mund të krijohet fondi i Akademisë dhe në mënyrë shumë profesionale mund të ruhen librat e shquar të Akademisë?!

Shikoni se çfarë librash merr Akademia. Kam pyetur njerëz performant në bibliotekat shqiptare dhe u kam thënë: Këto lista librash që merr Akademia a janë në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë? Më kanë thënë “po”.

Zonja dhe zotërinj deputetë që jeni iniciatorë, a ka bërë ndonjë studim enti botues? A e dini se kopja e një libri që boton Akademia ka një kosto reale 300 deri në 400 mijë lekë të vjetër, ku çdo shtëpi botuese do të kishte dalë e falimentuar, sepse botohen libra me 2000 – 3000 kopje dhe shiten vetëm 30 kopje? Po të tjerat ku janë? Çfarë është kjo politikë? Çfarë librash botohen, kur librat shkencor për historinë mund t'i botojë me efikasitet Instituti i Historisë, ai i Gjeografisë, për gjeografinë dhe ai i Gjuhësisë, për gjuhësinë?

Shikoni përkufizimet, në pikën 7, të nenit 5, thuhet: “...të botojë organe periodike...”, pra janë shumë, “... dhe vepra të tjera me nivel të lartë ndikimi shkencor”. Unë nuk i kuptoj fjalët “vepra të larta me ndikim shkencor”. Nëse gjeni një formulim të tillë, unë po jua jap fjalën se do ta konsideroj veten, se nuk punoj në fushën e epistemologjisë dhe as të historisë së shkencës.

Në nenin 9, “Anëtarët e asamblesë”, krejtësisht i shfokusuar. Në pikën 6 të nenit 9 thuhet: “Të marrim informacion për punën shkencore që bëhet nga institucionet kërkimore-shkencore dhe nga institucionet e arsimit të lartë”. Me çfarë tagri kërkon të marrësh informacion? Këta nuk e dinë akoma se sa universitetet dhe institucionet shkencore janë të pavarura dhe autonome. Këtyre institucioneve nuk mund t’ua kërkosh informacionin, por mund t’u lutesh. Këtë ua ka vënë në dukje edhe mendimi i qeverisë, i cili ka ardhur përpara 5 – 6 ditësh.

“Të japim ekspertizë dhe këshillime për institucione shtetërore.” Kush ua kërkon? Ka të drejtë vendimi i qeverisë që ka ardhur. Kujt ua jep? Ti mund t’ua japësh, por rëndësi ka kush të dëgjon.

“Të marrim pjesë në senatet akademike.” Çdo universitar do të vërë duart në kokë kur të dëgjojë që një anëtar i Akademisë mund të marrë pjesë me të drejta të barabarta në senatet e universiteteve. Në cilin ligj bazohet, sepse ligji e ndalon?!

“Të marrim pjesë në njësitë e grupeve të punës për kërkimin në fusha të caktuara.” Si do të marrin pjesë në kërkimin shkencor në Akademi? Për shembull, nëse unë jam në një institucion kërkimi shkencor dhe e bëj atje punën shkencore, si do të marr pjesë edhe në një kërkim shkencor që bën Akademia? Të gjitha këto janë të pabazuara dhe në kundërshtim me ligjin.

Në pikën 5 të nenit 6 thuhet: “Anëtarët e asamblesë që mbushin moshën 75 vjeç marrin statusin “Anëtar i meritës”. Çfarë do të thotë të jesh në Akademi deri në moshën 75 vjeç, me gjithë respektin për moshën, pjekurinë dhe eksperiencën? Kjo do të thotë që një profesor del në pension 68 vjeç dhe për 7 vjet rresht është i shkëputur nga kërkimi shkencor, dhe është ai që pretendon të japë gjykim për kërkimin shkencor. A ka bërë kush ndonjë studim se sa janë të integruar në departamente, në grupe kërkimi shkencor dhe në institucione kërkimi shkencor ata që janë 70, 75 apo 80 vjeç? Nuk janë më, sepse kanë dalë në pension.

Në platformën time unë jam partizan që personi i nderuar që ka respektuar veten dhe ka kontribuar, por në një moment të caktuar për shkak të moshës 68 apo 70 vjeç del nga sistemi i kërkimit shkencor, nuk ka mundësi më të jetë në forumin më të lartë të kërkimit shkencor. Pse? Sepse bëhet pengesë.

Më thonë: po tradita? T’i kthehemi traditës. Të gjithë korifentët e asaj Akademie kanë qenë punonjës shkencorë në institutet përkatëse, të Gjuhësisë, të Historisë, të Letërsisë dhe mjek të shquar. Degradimi i Akademisë filloi atëherë kur me moshën, nga pikëpamja demografike, akademikët filluan të kenë një status akademiku, ndërkohë që ishin shkëputur nga kërkimi shkencor. Ngel mbrapa dhe bëhesh pengesë për të tjerët.

Ky projektligj bie në kundërshtim me Kushtetutën që kërkon ekuilibrim të të drejtave dhe detyrave. Këta *emeritus* për shkaqe pragmatiste, pra mbi 75 vjeç, paskan të drejtë të zgjedhin, por çlirohen nga e drejta për t’u zgjedhur. Pra, të marrësh pjesë në një asamble ku t’i zgjedh, por nuk zgjidhesh! Cili parim juridik e pranon këtë gjë? Pra, ti ke të drejtë të zgjedhësh dhe ke detyrë të marrësh pjesë, por nuk je i domosdoshëm për kuorumin; si të vish apo të mos vish, nuk ka ndonjë gjë. Kjo nuk ka asnjë pikë ku të mbahet.

Vazhdojmë me pikën 2 të nenit 14 “Titujt akademikë dhe akademikët e asociuar janë tituj shkencorë dhe shoqërohen me një pagesë të veçantë”. Shikojeni konceptin “pagesë”, jo pagë, jo onorar dhe as shpërblim. Kjo pagesë të bëhet për punën, për kontributin apo për titullin?

Ata thonë: “Po, si profesori që merr një pagë më shumë edhe akademiku të marrë një pagë më shumë”, por nuk është e njëjta gjë. Profesori i asociuar merr një shtesë page, sepse supozohet se bën një punë më të kualifikuar se doktori. Këtë kualifikim e ka të mbështetur në standarde të matshme, kurse akademiku nuk është akademik për shkak se është më i zoti se të tjerët, sepse nuk shkon në bazë standardesh, por sepse zgjidhet.

Zonja Milva, këtu dallohet gjëja, sepse unë jam për shpërblimin e akademikut në bazë të punës. Unë nuk jam për privilegje dhe ta marrë papunuar shpërblimin. Çfarë pune do të bëjë akademiku, kur të gjitha funksionet që i janë dhënë akademikut, dalin se janë në kundërshtim me ligjin, ashtu siç e thotë edhe mendimi që ka sjellë Këshilli i Ministrave?!

Në nenin 17 thuhet: “Anëtarët e asamblesë ndahen në seksione.” Shikoni formulimin, nuk ndahet asambleja në seksione, por anëtarët. Kjo do të thotë se seksioni është pjesë e asamblesë sipas këtij formulimi. Atëherë, përse quhet seksioni si element strukturor i organigramës së Akademisë, kur seksioni qenka vetëm një pjesë e Asamblesë? Pjesa nuk mund të jetë e të njëjtit status, me të njëjtin status ontologjik si e tëra. Pra, ose është pjesë dhe nuk ka nevojë të vendoset në organigramë, ose është më vete. Por problemi është se ato janë më vete. Pyetja ime është: çfarë pune do të bëjë seksioni? Ju lutem pyesni se cilat janë rezultatet e kërkimit shkencor në seksione dhe do të shikoni se si do të jetë rezultati.

Aty thuhet: “Pranë Akademisë ngrihen edhe komisione të përhershme apo të posaçme”. Komisionet e posaçme vihen në strukturë, të cilat mund të ngrihen ose mund të mos ngrihen. Por nuk thuhet se për çfarë do të vlejnjë komisionet e posaçme? Çfarë janë? Janë grupe pune? Pra, nuk ka asnjë përcaktim.

Neni 20 “Akademia e të rinjve”. Si mund të jetë akademia e të rinjve pjesë e Akademisë, sepse ai që është anëtar i Akademisë së të rinjve duhet të jetë akademik. Pra, duket sikur mbështetet rinia, por në fakt ka diskriminim.

Nuk bëhet asnjë dallim mes anës shkencore, administrative dhe ekzekutive. Në nenin 22 përcaktohet se kryesia e Akademisë së Shkencave është edhe drejtuese nga pikëpamja e strategjive dhe e shkencës, por është edhe me titull ekzekutiv, drejton edhe administratën, sepse kancelari, sipas këtij projektligji është thjeshtë shefi i administratës. Po të shikoni se si bëhet menaxhimi i parasë në Akademinë e Shkencave, për këtë do të flas pak më vonë, do të shikoni një abuzim të madh me paratë publike. Pra, vazhdon e njëjta formulë.

Si përfundim, pa ju marrë shumë kohë, duhet parë nen për nen, sepse çdo nen është një minierë gabimesh, nonsesesh dhe paradoksesh.

E para, ky projektligj bie në kundërshtim me ligjet në fuqi, sikurse e thekson edhe mendimi i Këshillit të Ministrave i firmosur nga zëvendëskryeministri Erion Braçe. Unë jam dakord me atë që ka sjellë qeveria.

E dyta, nuk e zgjidh problemin e madh demografik në Akademinë e Shkencave, pra problemin e plakjes e lë siç është.

E treta, nuk i jep zgjidhje pozicionimit specifik të Akademisë së Shkencave. Çfarë është Akademia e Shkencave, akademi, institut kërkimi shkencor, kupolë për të mbajtur në varësi institucione kërkimi shkencor apo komitet shtetëror për koordinimin e punës shkencore të institucioneve? Cila prej tyre është? Defekti është në palcë.

E katërta, nuk ndanë administratën, ekzekutivin nga drejtimi shkencor.

E pesta, ka struktura fluide që nuk kuptohet se çfarë janë, siç janë komisionet, seksionet, madje thuhet se Akademia ka të drejtë të ngrejë edhe institute. Atëherë, çfarë është Akademia, agjenci që bën kërkim shkencor në plan të parë apo ka të drejtë të ndërtojë edhe institute, pra të jetë kupolë që mban brenda vetes edhe institute të tjera kërkimore-shkencore? Pra, i bie që instituti që është kërkimor dhe shkencor brenda vetes ka edhe institute të tjera kërkimore - shkencore. Kjo është nonsens dhe pa logjikë. Por edhe për themelimin e këtyre institutivë, që në raste të tjera bëhet me kritere të tjera, Akademia thotë: “Ne e marrim vetë vendimin t’i krijojmë, t’i prishim” e kështu me radhë. Po këtë nuk e lejon ligji.

Unë kisha 4 pyetje për zotin Redi Shtino. A ka reformim apo jo ky projektligj? Unë mendoj se nuk ka. Ky projektligj jo vetëm që nuk ka rithemelim, ashtu siç është kërkuar, po nuk ka asnjë risi.

Ju i keni studiuar të dyja platformat, cili është mendimi juaj, ku ka element reformues, te platforma që prezantohet në mënyrë alternative apo te projektligji? Mua më ka ftuar vetë qeveria që të kontribuoj dhe nuk është ndonjë punë e madhe edhe nëse dështoj, nuk besoj se do të mërzitem me nipin tim. Pra, cili është mendimi juaj? Cili është dhe cili ka qenë mendimi i ministrisë?

Pyetja e tretë, a ka ndonjë ekspert të huaj që i ka ekspertizuar të dyja platformat, në mënyrë informale ose formale?

E katërta, pse u ndërpre puna me komunitetin? Përse u trajtua në atë mënyrë komuniteti universitar, ku pasi u morën vendimet, profesorë të nderuar, departamente e të tjera me radhë u injoruan tërësisht nga Ministria e Arsimit?

Për këto katër pyetje, nëse është e mundur kërkoj mendimin tuaj.

Çështja e tretë, përse Akademia nuk është në gjendje që të reformohet nga brenda, siç gabimisht është bërë? Pra, këtu është rrënja e atij projektligji të dobët dhe që nuk reformon.

Unë dua të di ndryshimin mes këtij projektligji dhe ligjit ekzistues, por për mua nuk rezulton, sepse nuk ka asnjë ndryshim. Atëherë, përse të mos ruhet ligji që është, t'i bëhet një amendament i thjeshtë dhe më vonë, kur të piqu kushtet, të bëhet një reformism? Unë jam i bindur që shoqëria shqiptare dhe komuniteti universitar e shkencor do ta bëjnë një ditë Akademinë e Shkencave, do ta bëjnë për turpin tonë që jemi atje. Unë po shpëtoj turpin tim.

Arsyeja është se në Akademinë e Shkencave nuk është zbatuar ligji ekzistues me pasoja financiare që, sipas mendimit tim, nuk janë në përputhje me normat ligjore në fuqi.

Kam kërkuar audit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe nga organizma të tjera. Jam këtu dhe ju kërkoj me shumë përulje të ngrini një komision hetimor parlamentar për të parë se çfarë bëhet me paratë publike në Akademinë e Shkencave. Duke e thënë këtë, çliroj veten time nga përgjegjësia për të thënë: është kjo apo ajo, sepse nuk jam specialist, por po j'ua lë përgjegjësinë juve dhe është e pamundur që ju të mos veproni.

Në nenin 6/1 të ligjit në fuqi thuhet: "Statusi i anëtarit të rregullt të asociuar mbaron kur mbush moshën 75 vjeç". Pyetja ime është: a vazhdojnë të marrin honoraret e akademikut edhe pas moshës 75 vjeç në Akademinë e sotme?

"Statusi i anëtarit mbaron kur zgjidhet në funksione drejtuese në partitë politike apo në organet kushtetuese." Pyetja ime është: a ka njerëz që marrin shpërblim, pavarësisht se ky nen i detyron të mos jenë anëtarë të Akademisë së Shkencave?

"Me pagë me kohë të plotë mund të jenë vetëm anëtarët e kryesisë dhe drejtuesit e seksioneve." Pyetja ime është: veç drejtuesve të seksioneve, a ka akademikë të tjerë që janë të punësuar me kohë të plotë dhe që marrin pagë të kundërligjshme në Akademinë e Shkencave?

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëro.

Ismet Beqiraj – Zoti Fuga, e di që sot doni të shkarkoni të gjitha gjërat që keni, të cilat i keni shprehur edhe në media, dhe jeni në të drejtën tuaj që të kërkon kontroll parlamentar për përdorimin e fondeve publike e të tjera, por ne kemi një axhendë të përcaktuar sot, prandaj ju bëj thirrje edhe një herë, por edhe nga kolegët e tjerë, që të futeni në draftin që po diskutojmë, sepse do të na ndihmoni.

Fatjona Dhimitri – Zoti Beqiraj, nuk mendoj se ato çfarë po thotë profesori janë në kundërshtim apo i dëmtojnë mendimet tona për projektligjin.

Ismet Beqiraj – Ju lutem, ju lutem, të futeni në draftin që keni paraqitur...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë po kërkojmë. Ne na ka ardhur zyrtarisht një platformë, që nga platformë është kthyer në një propozim për projektligj.

Artan Fuga – Më falni, kush jua ka dhënë atë broshurë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Kë, këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, na keni sjellë një platformë, të cilën kërkojmë që ta prezantoni, sepse kjo na intereson ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Zoti Beqiraj, ju lutem, lëreni profesorin të shprehë mendimin e tij, pastaj ndërhyri!

Ismet Beqiraj – Lidhur me abuzimet se kush merr rrogën dhe kush nuk e merr, mund t'i drejtoheni asamblesë së Akademisë dhe keni të drejtë t'i drejtoheni edhe KLSH-së...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mua më intereson kjo, ndërsa për të tjerat ju e keni të gjithë të drejtën ligjore që t'ia kërkon asamblesë, që është institucioni i Akademisë, ku ju jeni pjesë, si dhe të gjitha hallkave të tjera, edhe KLSH-së. Ne na intereson kjo që na ka ardhur me broshurë, si propozim për projektligjin.

Fatjona Dhimitri – Zoti Beqiraj, ju mendoni se sjellja e atyre fakteve cënon projektligjin e nismëtarëve tuaj?!

Profesor, ju lutem vazhdoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Artan Fuga – Zoti Beqiraj, unë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, se do të vij edhe aty...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A mund të flas edhe unë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, mos më thoni: “Jo mo, jo”

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Profesor, ju lutem vazhdoni.

Artan Fuga – Dakord, zoti deputet, ju fala. Mund të vazhdoj?

Fatjona Dhimitri – Profesor, mbledhjen e drejtoj unë. Po i dëgjoj deputetët e tjerë dhe mendimet e tyre, por i ftuar jeni ju dhe ne do t'ju dëgjojmë deri në fund.

Po i kërkoj edhe një herë maxhorancës, ju lutem, të kemi durimin ta dëgjojmë profesorin deri në fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord një sekondë.

Milva Ekonomi – Zonja kryetare, meqenëse u kërkua fjala për procedurë nga deputeti Beqiraj, si masë e Rregullores, ju duhet të respektoni kohën e procedurës dhe pastaj të mbani radhën e folësve. Ne e kemi ftuar profesorin dhe do ta dëgjojmë patjetër, por ju lutem respektoni radhën. Procedura ka dy minuta kohë dhe deputetit i jepet fjala. Mos harroni asnjëherë se në këtë tavolinë deputetët janë shumë të nderuar dhe të respektuar, prandaj me kujdes.

Fatjona Dhimitri – Profesor, vazhdojmë!

Artan Fuga – Milva, besoj se bashkë me ju edhe unë jam i respektuar këtu?

Milva Ekonomi – Patjetër!

Fatjona Dhimitri – Patjetër profesor, mund të vazhdoni!

Artan Fuga – Sepse u duk sikur unë nuk isha, por jemi bashkë.

Faleminderit!

Unë e kuptoj shqetësimin, prandaj ju pyeta: a keni minutazh të më dëgjoni? Ju thatë: “Po, mund të flisni”. Unë po përpiqem të flas pa abuzuar ...

Fatjona Dhimitri – Profesor, merrni kohën që ju duhet dhe vazhdoni!

Artan Fuga – Unë jam shumë koherent në gjërat që po them, se ai draft, siç bëra kritikën në 7– 8 pika në thelb, vjen për arsye se në Akademi ka probleme të menaxhimit, të cilat e bëjnë atë të mos dalë nga modeli i vet, prandaj i duhet një ndihmë nga jashtë. Kaq ishte. Pra, jam koherent.

Pasi bëra këtë kritikë, po arrija te pika e prezantimit tim.

Ju lutem, zoti deputet, me gjithë respektin që kam, konsiderojni të vlefshme dhe zyrtare nga ana ime vetëm dokumentet që ju jap unë, sepse qarkullojnë dokumente false, me pikëpamje që nuk janë të miat, prandaj e bëra këtë me shpenzimet e mia dhe në respektin tuaj ua solla. Ju lutem, qëndroni këtu, ato të tjerat nuk i njoh.

Ku konsiston propozimi im, i cili mendoj se i jep zgjidhje nevojave të vendit për një Akademi Shkencash, pritshmërive të komunitetit, prandaj ka gjetur atë mbështetje?

E para, mendoj se Akademia e Shkencave ka vend të jetë e shkencave dhe e teknologjisë, sepse teknologjia është më afër asaj që bën vendi ynë sot në lëmin e dijes, nuk bën shkencë të mirëfilltë, pra nuk krijon dot lehtë shkencë të mirëfilltë. Teknologjia, në kuptimin e gjerë të fjalës sipas koncepteve të caktuara, përfshin mënyra organizimi, mënyra sjelljeje, infrastruktura tekniko-shkencore dhe aplikime të shkencës. Pra, unë jam për një zgjerim të konceptit.

E dyta, jam për një rinovim dhe për një dinamikë të brendshme demografike, por edhe intelektuale të Akademisë. Unë jam me parimin dhe këtë propozoj: që kërkuesi shkencor, i cili

është në institutet e kërkimit shkencor ose në sistemin e kërkimit shkencor, sigurisht është edhe në Akademi nëse zgjidhet, del në pension në kërkimin shkencor; ashtu siç del profesori, ashtu del edhe akademiku, i cili bëhet i meritës dhe merr pensionin e nderuar. Akademiku është i nderuar nga i gjithë vendi dhe të gjithë i përulen, por shkon në pension siç del një profesor. Mund jetë 1 ose 2 vjet më shumë për të bërë resumimin e veprës së tij dhe pastaj vazhdon jetën e tij, duke u trajtuar me kontributin që ka dhënë. Pra, të gjithë ata që dalin nga sistemi i kërkimit shkencor të marrin daljen e meritës, ashtu siç ndodh edhe me profesorët.

E treta, unë jam për një hapje të Akademisë drejtë komunitetit, nuk mendoj që Akademia e Shkencave të ketë 5 veta në kryesi, të paguar si nëpunës; kështu ka qenë kur Akademia mbulonte të gjithë institucionet shkencore. Unë mendoj që në kryesi duhet të jenë 1 ose 2 akademikë që mund të punojnë atje, ndërsa pjesa tjetër të japin kontributin e tyre, siç bëhet në të gjithë akademitë e perëndimit.

Përveç akademikëve të rregullt, unë kam propozuar edhe akademikë korespondentë, siç është termi në akademitë perëndimore, ku mund të jenë 40, 50 ose 60 personalitete të shkencës dhe të teknologjisë në Shqipëri, të cilët nuk është nevoja të paguhen si nëpunës, por japin kontributin e tyre dhe marrin pjesë në projekte, dhe në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjithandej.

E katërta, unë jam për çburokratizimin e Akademisë së Shkencave, që do të thotë: kryesia nuk ka përse të merret me kontrollimin e administratës dhe të ketë tagër ekzekutiv në vendimet e përditshme, sepse na del ashtu siç është sot, ku kryetari Akademisë është edhe kryetar i asamblesë, edhe kryetari i ekzekutivit në Akademi, edhe kryetari i entit botues, por edhe ai që përcakton se kush do t'i bëjë tenderat, prandaj sot kemi një përqendrim të jashtëzakonshëm.

Unë nuk jam ndonjë partizan i madh i ligjit “Për arsimin e lartë”, por ky ligj e ka zgjidhur këtë gjë, që do të thotë se e ka ndarë drejtimin shkencor nga drejtimi financiar dhe administrativ. Pse ka frikë Akademia e Shkencave ta pranojë këtë gjë?

Unë jam që akademikët të mos marrin shtesë page, siç thuhet, por jam që shtesa e pagës të jetë e matur me punë.

E pesta, unë kam një pozicionim të Akademisë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe të shkencës, që kaosin që krijohet atje dhe ajo mungesë qartësie që nuk kuptohet se çfarë është Akademia, pra a është akademi e institucionit shkencor, a është tutelë mbi institucionet e kërkimit shkencor apo çfarë është, por edhe nga eksperiencat e caktuara, Akademia të ketë objektivat e veta, si: përpunimi i gjuhës shqipe shkencore, reflektimi i komunitetit mbi procesin e shkencës dhe mbi proceset, marrëdhëniet e shkencës me shoqërinë,

çështjet që kanë të bëjnë me varësitë e shkencave me njëra-tjetrën, që nuk studiohen në asnjë institut më vete. Pra, mendoj që Akademia të jetë metashkencë, të jetë një akademi e nivelit të dytë dhe të tretë, që do të thotë të jetë një reflektim mbi proceset e shkencës dhe të teknologjisë në Shqipërinë e sotme, të cilën kemi shumë nevojë që ta modernizojmë.

E gjashta, në broshurën që jua kam dhënë, kam thënë se janë 8 produkte vjetore për të cilat Akademia u detyrohet shoqërisë, institucioneve dhe komunitetit. Pra, kam ardhur te produktet dhe akademikët do të paguhën mbi bazën e realizimit të produkteve; mund të jenë 8, 18 apo 5 këtë mund ta diskutojmë. Por unë mendoj se Akademia duhet të përcaktojë se çfarë produktesh duhet të japë, pra përse është atje dhe jo të propozojë gjëra që janë në kundërshtim me ligjin.

Çështja e fundit, në vendimin nr. 392 të Këshillit të Ministrave “Mendimi i KM-së për projektligjin”, thuhet: “Në aspektin buxhetor vlerësohet se ky projektligj do të shoqërohet me një kosto shtesë financiare”. Neni 82 i Kushtetutës detyron çdo nismë ligjore që nuk vjen nga qeveria, të paraqesë nëse ka kosto shtesë apo jo. Ne kemi një fjali nga zonja Gjermani që thotë: “Nuk ka kosto shtesë”, e cila besoj se e ka depozituar në komision. Qeveria thotë se ka kosto shtesë, ndërsa Akademia e Shkencave na thotë janë të dyja, pra thotë: “Nuk ka kosto shtesë, por në zbatim të këtij ligji më vonë mund të ketë kosto shtesë”. Çështja e problemit të relacionit financiar është çështje kushtetuese, që në momentin e parë që ky projektligj është paraqitur pa relacion financiar, nuk është në respekt me Kushtetutën dhe as sot e kësaj dite nuk kemi një relacion financiar. Unë nuk quaj relacion financiar atë që shkruan Akademia e Shkencave, e cila me anë të një shkrese thotë: “Sipas mendimit tonë”. Pra, sipas mendimit të kujt: të asamblesë, zyrës së financave apo të nënkryetarit Vaso Tole? Çfarë ka mbledhur? Ku është numri i protokollit? Mendimi ynë është cili?

Zoti deputet, problemi është kushtetues, që do të thotë: unë kërkoj se ku është relacioni financiar, ku përfshihen shpenzimet, të ardhurat sipas zërave, pritshmëritë dhe shuma në fund e krahasuar me shumën që është, i cili është bërë nga ekspertë financiarë të certifikuar nga Ministria e Financave. Këtë e konsideroj unë relacion financiar.

Ne marrim projektligjin, ndërkohë që Këshilli i Ministrave thotë se nuk ka akoma një raport financiar! Ne ose do të respektojmë Kushtetutën dhe kërkojmë relacionin për të vazhduar, më falni që e them këtë, ose kot që vazhdojmë!

Megjithatë, unë propozoj, unë kam mendimin, unë sugjeroj shumë modestish që projektligji është i papjekur si frymë, si parim, por edhe nen për nen; gjithashtu, bie në kundërshti me kuadrin ligjor që është në fuqi.

Çdo njeri që njeh jurisprudencën formaliste do të thoshte: “Çfarë po bëj akoma këtu?”.

E dyta, është në mospërputhje me kërkesën e Kushtetutën, sepse nuk kemi akoma një relacion financiar.

Propozomi im i dytë është që me këtë çështje të rimerret Ministria e Arsimit. Unë besoj se kjo ministri i ka të gjitha kapacitetet që ta çojë përpara këtë gjë.

Së treti, mendoj se duhet implikuar komuniteti universitar dhe shkencor në rinovimin e Akademisë, sepse për arsyet që ju thashë, Akademia është e implikuar në keqpërdorim të parasë publike dhe nuk e kapërcen dot vetveten.

E katërta, ne jemi përpara një Akademie, të cilën e thërrasin të japë mendime, por sipas meje ajo është një institucion i njollosur juridikisht dhe antiligjor, sepse ka bërë zgjedhje të paligjshme.

Unë pres që Presidenti i Republikës, i cili e ka atë tagër, të jetë konsekuent dhe të mos emërojë zgjedhje të paligjshme. Unë nuk kam të drejtë të kërkoj asgjë, por them se jemi duke dëgjuar dhe unë jam pjesë e një institucioni ku janë bërë zgjedhje të paligjshme. Po të doni ju jap dokumentet, sepse i kam, por besoj se nuk është nevoja.

E pesta, unë propozoj që, siç është censuruar platforma alternative, të bëhet pjesë e diskutimit në komunitet, ndoshta edhe me zëra të tjerë të pavarur, pra, të respektohet mendimi alternativ.

E gjashta, t'i thuhet Akademisë së Shkencave se mendimi i Këshillit të Ministrave për projektligjin është i tillë dhe kërkon një reflektim serioz, sepse jo vetëm që nuk kemi rithemelim, por nuk hedhim asnjë hap përpara me ligjin që është bërë. Juristët e nderuar që janë këtu e dinë fare mirë që një ligj i ri bëhet, sepse ndryshohet një ligj i vjetër.

E fundit, zoti deputet unë po ju them se në Akademinë e Shkencave ka abuzime financiare. Ju lutem, mbajeni shënim këtë gjë, sepse është përgjegjësia juaj.

Unë ju falënderoj, ju kërkoj ndjesë për zgjatjen e kohës dhe ju them se të gjitha që kam thënë janë në përgjegjësinë time, nuk janë aspak një shkarkim psikologjik, por janë një reflektim 10-vjeçar.

Unë kam ardhur këtu i ftuar nga ju për t'ju respektuar ju, me shpresën të ju, pavarësisht krahëve nga vini, jam i bindur që është një nevojë e madhe e shoqërisë për një Akademi Shkencash dhe jam i bindur që Shqipëria një ditë do ta ketë, por do të ishte në nderin tuaj dhe tonin që të ishim ne gjenerata që do ta bënim këtë gjë.

Ju kërkoj falje për kohën e humbur, por edhe për ndonjë këmbëngulje në mendimet e mia. Unë jam gjithmonë i disponueshëm për t'iu përgjigjur kërkesave tuaja.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Profesor, ju falënderoj për prezantimin tuaj dhe për të gjitha mendimet tuaja alternative lidhur me projektligjin!

Profesor, të gjitha propozimet që keni, mund t'i depozitoni pranë sekretarisë së komisionit tonë, ashtu siç i keni depozituar, në mënyrë që gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit të mendojmë për të tilla propozime.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Shtino, profesori ju drejtoi disa pyetje, a mendoni se mund t'u përgjigjeni disa prej tyre?

Milva Ekonomi – Më falni, zoti Shtino, por e dua fjalën për procedurë. Profesori ka ardhur të bëjë dëgjuesën përpara komisionit. Në këtë rast nuk mund të merret parasysh kërkesa e bërë nga profesori për t'i bërë pyetje zotit Shtino, sepse profesori është thirrur për të na dhënë shpjegime për projektligjin. Procedura vazhdon me pyetjet e deputetëve për profesorin, nëse kanë, pastaj vazhdojmë me gjërat e tjera.

Zonja kryetare, të lutem, të respektojmë radhën e punës në komision.

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëroni profesor.

Artan Fuga – Kur iu drejtova zonjës Nikolla dhe zotit Shtino, iu drejtova me pyetje si dëshmitarë të atyre që unë thashë. Sigurisht që është tagri juaj që këtë dëshmi ta doni ose jo.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Zoti Shtino...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mendoj se zoti Shtino ka diçka për të thënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është kërkuar prania e zëvendësministrit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Shtino, a mendoni se mund t'i përgjigjeni ndonjë pyetjeje?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Fidel, prisni pak, sepse do t'jua jap fjalën.

Po, zoti Shtino.

Redi Shtino – Për sa i përket pyetjeve që bëri profesori...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Jo, të lutem, sepse ia kam dhënë dikujt fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Milva, e njoh shumë mirë Rregulloren.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ia kam dhënë fjalën zotit Shtino.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Shtino, ju lutem, mos u shmangni nga dhënia e përgjigjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bujar Çela – Zonja kryetare, në respekt të madh ndaj jush, ndaj familjes Fuga dhe të gjithë kolegëve...

Fatjona Dhimitri – Ju lutem, mos përmendni këtu familjen, sepse kemi përpara një akademik. Ju lutem, mos kaloni në përvetësime!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bujar Çela – Të lutem, një sekondë. Sa vend i keq qenka ajo karrige! Ju lutem, sepse thamë se kemi ardhur të bëjmë një gjë ndryshe. Unë e respektoj profesor Fugën...

Fatjona Dhimitri – Kur të jeni ju në karrigen time, atëherë drejtojeni ndryshe komisionin.

Bujar Çela – Profesorin e falënderoj për ato që tha, se me të vërtetë është krijuar një turbullirë nga ajo që kemi dëgjuar deri tani, për të qenë korrekt. Ne kemi dëgjuar akademikë, rektorë, kemi lexuar sa kemi mundur. Gjithashtu, pamë se ndër ata që diskutuan kishte të majtë dhe të djathtë, por mendoj se në fund fare shkenca është shkencë dhe pasqyron kombin. Një komb pa shkencë dhe pa Akademinë e Shkencave nuk mund të kuptohet. Nuk e barazoj dot me flamurin apo me hymnin, por është një tregues shumë i rëndësishëm i një kombi.

Unë mendoj se përgjigjet e zëvendësministrit, pa e marrë në mbrojtje, nuk kanë lidhje, sepse ne kemi ardhur t'ju dëgjojmë ju...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një sekondë, në mënyrë që ato që ju thatë, ne t'i pasqyrojmë në ligj, sepse ky është edhe interesi juaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një sekond, ne nuk ju shikojmë si opozitar, por si njeri të kompletuar dhe akademik, që doni të reformoni trupin tuaj. Kjo është shumë e rëndësishme dhe unë me këtë ndjesi po ju dëgjoja.

Ndërsa për pyetjet që i bëtë zëvendësministrit ose ish-ministres për formatin se si janë krijuar grupet e punës, është një çështje tjetër. Pra, a ka parregullsi në të shprehurit ligjor, në leksik, në formatim, ku pika 3 kundërshton pikën 5 e të tjera. Unë mendoj se grupi i punës në bashkëpunim me këshilltarët tanë do të bëjnë rregullimet e duhura, sepse në fund fare ky ligj nuk pasqyron bla – bla-të e njërës apo të tjetrit, më falni, të më mirëkuptoni, por pasqyron një ligj. Ky ligj, po të jetë i bërë mirë dhe i dëgjuar shumë mirë, do të jetojë më shumë se ne, këtë

e kemi nga përvoja, sepse kemi bërë disa herë ligje. Alarmi që dha Kryeministri për Akademinë, i cili tha se është një vend kështu dhe ashtu, doli se ishte i vërtetë. A e kemi marrë “kthesën e rrugës”? Po, të gjithë e kemi marrë “kthesën e rrugës” herë të gabuar, herë të detyruar, por ndonjëherë ka qenë e domosdoshme, sepse mund të rrëzoheshim nëse nuk e merrnim kthesën, prandaj janë tabelat.

Unë mendoj që pas kësaj dëgjese shumë të gjatë dhe shumë informuese, duke respektuar edhe akademikun Fuga, ta mbyllim dëgjuesën dhe si komision të vazhdojmë reflektimin për këto nene dhe pika, që ta ndërtojmë ligjin sa më mirë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Po profesor, mund të vazhdoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do ta jap fjalën edhe ty Fidel. Të lutem, vazhdo profesor!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do ta jap fjalën edhe ty.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër që do t’i bësh edhe pyetjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Artan Fuga – Nuk jam unë këtu për të bërë pyetje, kanë të drejtë zotërinjtë deputetë, por unë kam për detyrë të them se për ato që do të them, kam disa dëshmi. Nëse doni, mund t’i merrni; nëse nuk doni, mos i merrni.

E dyta, mendimi im është ajo që thashë: nuk është puna të bëjmë korrektime të neneve, por them se ky ligj nuk sjell asnjë ndryshim në raport me atë që është dhe proceduralisht nuk është në respekt të normave. Kaq!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, profesor!

Urdhëroni Fidel!

Fidel Ylli – Faleminderit, kryetare që më dhe fjalën.

Unë e dëgjova me shumë vëmendje të nderuarin Fuga. Këtu kemi një punë shembullore që është bërë nga ana e tij, për sa i përket platformës, por unë dua t’i bëj disa pyetje. E para, sa akademikë e kanë mbështetur platformën tuaj?

E dyta, a e dini ju se zgjedhjet në Akademinë e Shkencave janë detyrim ligjor në kushtet kur përfundon afati kohor për çdo mandat drejtues?

E treta, platforma juaj a është dorëzuar zyrtarisht në Akademinë e Shkencave?

E katërta, mbas fjalës së zotit Rama në datën 5 nëntor, e gjithë praktika është e dokumentuar në një libër që Akademia e Shkencave e ka prodhuar dhe na e ka dhënë ne dhe kryetares.

Ju thatë se në grupin e punës nuk ka asnjë jurist. Unë mendoj se kjo është e pavërtetë, pasi këtu kam një listë të grupit të punës me firmën e ministres së asaj kohe, Lindita Nikolla. Zoti Fuga, me urdhër nr. 29, datë 16.01.2018, në grupin e punës marrin pjesë: Skënder Gjinushi, Ervin Demo, Luan Omari, Beqir Meta, Kosta Bajraba, Apollon Baçe dhe Shaban Sinani. Po ju them se Luan Omari është babai i jurisprudencës shqiptare, akademik dhe profesor në këtë fushë. Pra, ju thatë se nuk ka asnjë jurist dhe kjo është një e pavërtetë, prandaj duhet që “Çezarit t’i japim atë që meriton” dhe të mos themi të pavërteta përpara opinionit publik.

E fundit, që e them me përgjegjësi, jo thjeshtë se është shprehur Kryeministri, por ky projektligj ka pasur vëmendjen e maxhorancës dhe të komisionit tonë, prandaj nuk ju kemi vënë në kokëfortësinë e komisionit, se ne mund të thoshim: “Zoti Fuga do të vijë bashkë me të gjithë akademikët e tjerë”. Pra, duke parë se kjo që keni bërë ju i kontribuon punës dhe projektligjit, ju kemi bërë një seancë që se kemi bërë për asnjë njeri tjetër, duke ju dhënë kohë për të shprehur mendimet tuaja. Ky është serioziteti i këtij komisioni, i kësaj maxhorance që t’i japim shkencës shqiptare atë që meriton.

Të jeni i sigurt se nuk ka asnjë lloj problemi për të kundërshtuar platformën tuaj, por ne do t’i marrim në konsideratë edhe vërejtjet që bënë të gjithë rektorët e univeristeteve, edhe platformën tuaj, që në fund, kur ta votojmë projektligjin, të ketë marrë formën e duhur.

Artan Fuga – Zoti Ylli, pa dyshim, që keni treguar një bonsens, vetëm se po ju them se në proces nuk kam ardhur me iniciativën time. Në një moment të caktuar, pasi e mbarova iniciativën time në Akademi, më thanë: “Jo, nuk do të bëhet kjo”. Jam thirrur publikisht nga kreu i ekzekutivit, i cili tha që të shikohet edhe ajo platformë.

Pra, këtu nuk është ndonjë rëndësi e madhe që mbrapa kësaj platforme është një akademik apo janë 20, sidomos...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do t’ju përgjigjem. Nëse ju më thatë këtë, unë ju falënderoj, por nuk besoj se ishte e pamerituar, sepse jam ftuar nga administrata.

Sa akademikë e kanë mbështetur? Unë nuk e di se çfarë kanë thënë rektorët dhe nuk kam përse ta di, por unë di që zoti Shtino ka një listë me dhjetëra kërkues shkencor që janë shprehur pro asaj platforme, mund të jenë edhe 100, i keni të gjithë në dokumente.

Zoti Ylli, po ju them një të vërtetë, nuk është vetëm një Artan mbrapa kësaj platforme, janë departamente e fakultete të shprehura dhe dhjetëra e dhjetëra pedagogë të moshave të ndryshme dhe gradave të ndryshme, që janë shprehur pro platformës. Po çfarë bëhet me ta? Kur Ministria e Arsimit i hyri procesit të konsultimit dhe ata u shprehën, atyre u thanë “stop”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Ju lutem, a ka mundësi të mos e ndërprisni profesorin? Profesor, mund të vazhdoni!

Artan Fuga – A mund t’i përgjigjem zotit Ylli?

Fatjona Dhimitri – Po, vazhdoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, mos ndërhyini, nuk e keni kërkuar fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Udhë të mbarë!

Artan Fuga – Zoti Ylli, në Akademinë e Shkencave, mbrapa kësaj platforme jam vetëm unë.

Në shkencë nuk funksionon si në politikë me shumicë votash apo si në një juri gjyqësore, ku sipas kuorumit të gjykatës, ashtu merret vendimi. Me çfarë jua vërtetoj këtë? A e dini ju që në zgjedhjet që u bënë në vitet 2016 – 2017 u votua 100% nga akademikët, me përjashtimin tim? Nuk kaluan dy muaj dhe thanë se zgjedhjet nuk ishin të mira, prandaj duhet të reformohemi. A e dini që për 10 vjet vetëm unë kam kërkuar reformimin? Në vitin 2017 kemi një vendim 100% të asamblesë që thotë: “duhet bërë rinovim”. Çfarë të bëj unë me këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Pyetja ishte: sa akademikë ju kanë mbështetur, ju thatë asnjë, nuk ka asgjë të keqe.

Artan Fuga – Jo, jo, thashë më shumë se kaq.

Fidel Ylli – Unë këtë doja të dija se sa të kanë mbështetur në një asamble, mbaroi pyetja, kalo te tjera.

Artan Fuga – Pyetja e dytë, afatet e zgjedhjeve. Ju keni shumë të drejtë që duhen respektuar mandatet, por ka situata të tilla që ligji nuk i parashikonte, që do të thotë: u bënë zgjedhjet, doli kryetari dhe nënkryetari në vitin 2017, në një moment të caktuar dhanë të dy dorëheqjen dhe institucioni u fut në një krizë të paparë. Institucioni ka qëndruar pa zgjedhje rreth 1 vit e pak. Çfarë kërkoja unë? Unë kërkoja që ose të bëjmë një kalendar ku të caktojmë zgjedhjet, ose të presim edhe 2 muaj. Pra, të prisnim nga 24 maji, që u bënë zgjedhjet, sepse kemi 1 vit e gjysmë në atë boshllëk që me të drejtë e thoni, të presim edhe dy muaj që të mos

e vëmë Kuvendin përpara faktit të kryer që ne po zgjidhemi. Pra, nga 24 maji deri në 24 korrik ishin edhe dy muaj. Ky është gjykimi im për pyetjen e dytë.

Pyetja e tretë, a është dorëzuar në Akademi? Unë mund t'ju them se është dorëzuar, por nuk kam asnjë provë. Ju tregova kalendarin zyrtar të Akademisë, po gjetët një rend dite ku do të shqyrtohet platforma alternative e Artan Fugës. Unë i dorëzoj të gjitha, prandaj ua kam sjellë, prandaj u zgjata, prandaj ju fola për procedurë.

Zonjës Lindita Nikolla i kam kërkuar: a ka mundësi t'i thoni Akademisë që ta marrë, sepse mua nuk më dëgjojnë? Prandaj ju paraqita dokumentet. Ajo e di shumë mirë, sepse ajo e ka kërkuar dhe ia kanë refuzuar. I keni shkresat aty. Çfarë të bëj më shumë, zoti Ylli?

Fidel Ylli – Si e kanë refuzuar? E ke çuar ti në protokoll dhe nuk e kanë pranuar?

Artan Fuga – Po.

Fidel Ylli – Më jep një fakt, sepse kjo qenka për ndjekje penale.

Artan Fuga – Unë e kam faktin këtu.

Fidel Ylli – Nuk është fakt ky, më jep një fakt për Akademinë.

Artan Fuga – Unë e kam faktin këtu, këtë mund ta thotë zonja Nikolla.

Fatjona Dhimitri – Zonja Nikolla e kërkuat fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Artan Fuga – Zoti Ylli, po jua jap edhe faktin. Urdhëro, kjo është shkresa e refuzimit nga ana e sekretarit Vasil Tole, drejtuar ministres së Arsimit që ne nuk e marrim në shqyrtim këtë gjë.

Këtu ke edhe dëshminë e zonjës ministre, e cila na ka bërë një *e-mail*, ku thotë: “Unë dua që ju të merrni në shqyrtim këtë, por ju nuk po e merrni, prandaj po e tërheq në ministri dhe mund të vini të bëjmë një diskutim në ministri.” Apo jo zonja Nikolla?

Ja ku i keni, zoti Ylli, është e datës 03.05.2018. Pra, jemi brenda kalendarit të reformës.

Për pyetjen, se në grupin e punës nuk ka një jurist. Edhe po të mos jetë një e vërtetë totale, nuk ka të bëjë me këto që po them. Cilli është problemi? Po, zoti profesor Luan Omari është jurist i Kushtetutës. Kur unë them një jurist, them për një jurist, që ka të bëjë me të drejtën administrative që rregullojnë këto. Unë kam një problem zoti Ylli, sepse mendoj se eksperti jurist nuk duhet të jetë në konflikt interesi duke qenë edhe akademik, këtë e kam parimore edhe në Akademi, sepse ne si Akademi themi: “unë jam jurist dhe them se është kështu”, po një minutë se eksperti duhet të jetë jashtë konfliktit të interesit, nuk mund të jetë akademik. Ky është koncepti im. Më fal se i rashë shkurt.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sapo jua shpjegova, nuk është jurist për administrativen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord!

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Fjalën e ka zonja Nikolla.

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Edhe një herë dua të shpreh falënderimin për akademikun Fuga, për të gjitha sqarimet që dha, dhe në vetë të parë të konfirmoj se gjithçka që shprehu me procedurën është ashtu siç e tha profesori.

Është e vërtetë që ka qenë zëri i parë për të reformuar Akademinë e Shkencave, në bazën e të cilave Kryeministri i Shqipërisë ngjizi një debat, ku u kërkua që zgjidhja dhe reformimi të dilnin nga vetë komuniteti i akademikëve dhe kërkuesve shkencorë.

Është e vërtetë që kam certifikuar, në detyrën e ministres së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, një grup pune, i cili do të bënte të mundur reformimin dhe të draftonte projektligjin. Grupe të tilla pune mund të ngrerë çdo ministër në cilësinë e tij. Nuk kam paragjykuar profesorët e nderuar dhe akademikët që kanë ardhur si propozim nga Akademia e Shkencave për të qenë në këtë grup pune, ashtu sikurse është e vërtetë që produkti i ardhur nga ky grup pune nuk u nxitua për t'u çuar në qeveri, por ka ndjekur një analizë shteruese, për të parë sa dhe si ky projektligj i draftuar sjell risi. Sigurisht, nuk ka pasur asnjë nxitim për ta diskutuar këtë produkt me komunitetin e gjerë shkencor.

Në cilësinë e detyrës sime si ministre e Arsimit, kam pasur të gjithë tagrin në fushën time të përgjegjësisë për të gjykuar dhe për të analizuar se cili nga produktet e ardhura i shërbente realisht reformimit, duke ndjekur procedurat.

Është e vërtetë që profesor akademik Fuga ka qenë një zë kritik, ka paraqitur platformën e tij për reformimin e Akademisë.

Është e vërtetë që akademikët kanë qëndruar strikt në rrugën e grupit të punës dhe miratimit të tij në asamble, duke qenë refuzues për ta bërë pjesë të diskutimit platformën Fuga. Në këtë moment Kryeministri i Shqipërisë ka kërkuar nga unë personalisht që të mos progresoj me draftin e ardhur nga grupi i punës, por të bëjmë një ballafaqim shumë më të gjerë edhe me platformën e akademik Fugës. Kërkuam dhe draftuam së bashku një axhendë se si do të operonim. Kam kontaktuar me grupin e punës, duke kërkuar që edhe ata të ishin proaktivë në këtë komunikim. Nuk e kanë parë të arsyeshme as ta bënin pjesë të diskutimit dhe as të bënin tërheqjen zyrtare të platformës së akademik Fugës.

Në cilësinë e ministres, por edhe në zbatim të porosisë së dhënë nga Kryeministri i Shqipërisë, kam kërkuar që autoriteti që kishte përgjegjësinë për këtë gjë, pra Ministria e

Arsimit, të ushtronte funksionet e saj. Kam tërhequr në Ministrinë e Arsimit, në mënyrë zyrtare platformën e profesorit dhe kemi kërkuar që të vijojmë debatin me të gjithë komunitetin shkencor, duke nisur kërkesën drejt institucioneve tona të arsimit të lartë dhe institucioneve që në fushën e tyre të përgjegjësisë kanë kërkimin shkencor.

Unë dua që edhe këtij grupi të nderuar të komisionit parlamentar, por edhe deputetëve të tjerë, t'ju bëj me dije që kemi kërkuar mendim për të dyja platformat edhe nga ekspertët e Komisionit European, të cilët në dijeninë time janë shprehur. Pra, duhet që edhe këto referenca të gjykohen dhe të merren parasysh nga ky komision.

Pas largimit nga detyra, nuk e di se si kanë vazhduar. Unë kam mirëkuptimin e plotë të punës të ministres aktuale si është operuar më tej. Por për sa kohë që unë kam qenë në krye të atij institucioni, kemi proceduar në këtë mënyrë, duke kërkuar një debat shterues për të dyja platformat, pra për ta hapur si debat dhe për të mos mbetur brenda Akademisë, si nga kërkuesit e tjerë, por edhe nga ekspertët ndërkombëtarë, të cilët në dijeninë time kanë kthyer përgjigje dhe kanë referuar se cila nga platformat prevalon për nga pikëpamja e risive reformuese të Akademisë së Shkencave, pra platformat e grupit të punës, kryesuar nga profesor Skënder Gjinushi apo ajo e akademik Fugës.

Sigurisht që ne do të kalojmë në mënyrë më shteruese edhe sugjerimet e grupit të deputetëve, të cilët kanë bërë ndryshime apo kanë parë këto interferenca.

Unë ju bëj thirrje, pa e paragjykuar komisionin, sepse e di që ky komision do të jetë në lartësinë e detyrës, që të mos nxitohemi dhe të shikojmë me përgjegjësi të plotë të gjithë mendimin e ardhur në lidhje me këto dy platforma, sepse interesi publik është përtej miratimit të një ligji për Akademinë e Shkencave, por është për të pasur realisht një Akademi të reformuar. Prandaj duhet të kemi të gjithë përgjegjësinë dhe të marrim edhe kohën e nevojshme për t'i parë të vërtetat në dritë të diellit dhe për të gjykuar ftohtë për platformat e ardhura.

Edhe një herë, faleminderit, profesor!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zonja Nikolla!

Po, urdhëro zoti Jenisheri.

Selami Jenishehri – I nderuar zoti Fuga, kam një pyetje, e cila më shqetëson shumë dhe mund të ketë rëndësi shumë të madhe për interesin publik dhe për Shqipërinë që duam. A mendoni se projektligji që ju propozoni nuk e penalizon përsëri marrjen jetë të vazhdimit të zbulimeve tona shkencore të mëdha, si ai i Profesor Shuajip Kraja, i cili ka zbuluar ilaçin për shërimin e kancerit dhe vaksinimin ndaj kancerit, për të cilën ka patentën e prodhimit zyrtarisht, por edhe progrese të tjera nga kërkues të tjerë shkencorë?

Nuk ka arsye që Shqipëria mban një qëndrim të tillë, sepse sipas meje kjo i shërben jetës së shqiptareve, por edhe mbarë njerëzimit, sigurisht që ka edhe pasoja të mëdha ekonomike. Pra, jam i interesuar të di nëse propozimi juaj e shmang këtë penalizim që i bëhet këtyre shkencëtarëve të mëdhenj, të njohur botërisht për këtë progres kaq të madh, ndaj të cilit ne kthejmë shpinën? Nëse mundeni përgjigjen jepen sa më shkurt, po ose jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Artan Fuga – Akademia siç është tani dhe siç e mendon ky projektligj është...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Zoti Selami, po përgjigjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Artan Fuga – Zoti deputet, po ju përgjigjem shpejt...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Profesor vazhdoni.

Artan Fuga – Zoti deputet, po ju përgjigjem me një fjali: po, varianti im i jep mundësi një shqyrtimi shumë rigoroz dhe dinjitoz të gjitha arritjeve shkencore. Kjo sot nuk realizohet. Për çfarë arsye? Për shembull, në asamble vjen një studim për mjekësinë dhe për këtë studim do të gjykoj edhe unë që jam në komunikim apo në filozofi, edhe ai që është në biologji, edhe ai që është në inxhinieri, pra nuk ka kompetencë.

E njëjta gjë ndodh edhe në mënyrën se si propozohet, ku anëtarët e asamblesë që nuk kanë të bëjnë fare me fushën nga vjen studimi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Projekti im e zgjidh.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, më dëgjoni. A e dini se si? Unë propozoj, për shembull: 40 apo 50 anëtarë që janë korrespondentë, të cilët brenda asamblesë do të krijojnë grupe sipas shkencave përkatëse. Pra, kur të vijë një zbulim nga shkencat mjekësore, nuk do të diskutohet nga unë që mund të jem matematikan apo inxhinier, por do të diskutohet nga mjekët, nga grupi i shkencave mjekësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti deputet keni shumë të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Zoti Selami, ju lutem.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Artan Fuga – Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Po zonja Milva.

Milva Ekonomi – Dua të falënderoj zotin Fuga për prezantimin e platformës që bëri. Gjithashtu, i bashkohem mendimit të zonjës Nikolla, që komisioni do ta marrë me shumë seriozitet punimin e këtij projektligji. Në vazhdim ne do të marrim kohën e nevojshme për të marrë dhe të gjitha sugjerimet që janë dhënë nga grupe të ndryshme të interesit, të ftuara deri më sot, por edhe mendimet që ka sjellë Këshilli i Ministrave.

Dua të sqaroj edhe një herë se për këtë projektligj angazhimi ynë në komision ka qenë maksimal. Të gjitha detyrat janë bërë sipas Kushtetutës dhe Rregullores, dhe çdo përgjigje që ka ardhur në komision, çdo mendim dhe çdo dëgjese është trajtuar në bazë të Kushtetutës dhe Rregullores. Gjithashtu, puna që do të bëhet nga komisioni, nga relatori, sekretaria dhe Shërbimi i Legjislacionit në parlament do të bazohen në Rregullore dhe në Kushtetutë.

Në veprimtarinë tonë, ne do të kemi të ftuar përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe nga komisioni nismëtar, prandaj në komision nuk kalon asgjë pa diskutuar dhe të gjithë do të përballen me mendimet e ardhura deri më tani. Pra, vetëm në bazë të kësaj pune, ne mund të draftojmë një ligj final për Akademinë e Shkencave. Prandaj, grupi i punës do të marrë kohën e nevojshme për të përfunduar këtë projektligj, i cili do të vijë në komision për miratim e votim dhe, më pas, kur të jetë i gatshëm, do të kalojë në seancë.

Fatjona Dhimitri – Po, profesor.

Artan Fuga – ... Lutja është kjo: ju lutem dëgjojeni përgjigjen e Ministrit të Arsimit, a ka apo nuk ka reformë nga njëri ligj ekzistues te ky që është? Pra, mund të merresh në mënyrë jostrukturore me këtë ligj dhe mund ta bësh shumë të mirë, por del se në raport me ligjin ekzistues nuk ke një produkt të ri. Prandaj pyeta: a ka Ministria e Arsimit një përgjigje, në këtë gjendje që është ky projektligj, a sjell reformë apo jo? Kaq!

Milva Ekonomi – Ne do ta thërrasim Ministrinë e Arsimit.

Artan Fuga – Ja ku e keni, që ta dëgjoj edhe unë.

Milva Ekonomi – Ju do ta dëgjoni nëpërmjet...

Artan Fuga – Po përse?

Fatjona Dhimitri – Zëvendësministri ka nevojë të mendohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëse keni ndonjë përgjigje, atëherë na e jepni.

Milva Ekonomi – Zoti Fuga,...

Fatjona Dhimitri – A keni nevojë të mendoheni, zoti zëvendësministër?

Milva Ekonomi – Ne kemi një Rregullore dhe sipas saj komisioni cakton datën kur do të thërritet Ministria e Arsimit në dëgjese. Nuk mund të jeni i ftuar ju, zoti Fuga.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po pra, prandaj na lini të veprojmë sipas Rregullores! Pse na e prishni procedurën e punës?

Zoti Fuga, ju lutem, ne dëgjuam me shumë respekt të gjitha gjërat që kishit për të na thënë për platformën tuaj dhe e kemi lexuar me gjithë respektin e duhur. Ju lutem shumë, lëreni komisionin të punojë sipas procedurës. E dimë ne kur do të thërrasim ministrinë dhe zotin Shtino për të na dhënë përgjigje.

Fatjona Dhimitri – Ju kërkoj ndjesë profesor! Zoti Shtino, përtej mendimit tonë dëshironi të shprehni diçka?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Redi Shtino – Për pyetjen e bërë nga profesori, ne përgjigjet do t'i japim në çfarëdo lloj forme, por sidomos me shkrim, meqenëse në këtë moment nuk është e përshtatshme që të ndërhyjmë. Por dua të përsëris atë që kam thënë edhe kur në këtë tavolinë kanë qenë përfaqësues të Akademisë së Shkencave, se ky proces ka filluar me iniciativën e ish-ministres Nikolla, në fillim të qershorit të vitit 2016 dhe është shumë më i gjerë dhe më i thellë se kaq.

Nevoja për reformimin e Akademisë së Shkencave, e kërkuar nga faktorë të ndryshëm, lindi rrugës kur u vendos që të ngrihen 3 grupe pune për të reformuar në themel sistemin e shkencës. Këto 3 grupe pune e kanë mbyllur produktin e tyre. Është realizuar strategjia e kërkimit shkencor 2017 – 2021 dhe për këtë gjë nuk flitet këtu, dhe më vjen keq. Pra, nëse duam të reformojmë Akademinë, si pjesë të strukturës së madhe të shkencës, ne nuk mund të mos i referohemi dokumenteve që ne, si ministri, përgatisim. Po e përsëris të njëjtën gjë që kam thënë, edhe kur kanë qenë të ftuar iniciatorët dhe përfaqësuesit e Akademisë së Shkencave, se nuk mund të shikohet reformimi i Akademisë së Shkencave jashtë reformimit tërësor të shkencës.

Aktualisht, jemi në fazën kur ligji për kërkimin shkencor ka përfunduar, është një draft, ku janë reflektuar edhe komentet e Komisionit European dhe për rrjedhojë është një ligj që duhet vlerësuar paralelisht me atë të reformimit të Akademisë së Shkencave, sepse duhen kuptuar hapësirat që lihen në administrimin e të gjithë kontekstit shkencor dhe kërkimor në Shqipëri. Do të ishte e izoluar në mënyrë të dëmshme, kur të diskutojmë çështjen e Akademisë, nëse nuk do të diskutojmë se çfarë do të bëhet me Institutin e Kërkimit Shkencor, me qendrat dhe agjencitë që sot janë operative, të cilat nuk bëjnë më kërkim shkencor dhe nuk japin as shërbim në fushën shkencore. Ky argument është aq i izoluar, i cili po të diskutohet vetëm në

kontekstin e ngushtë të reformimit të Akademisë së Shkencave, me bindje, produkti final nuk do të jetë ai që duhet dhe që meritojmë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Shtino!

I nderuar profesor, ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në seancën e sotme!

Uroj që mendimet dhe propozimet tuaja të merren parasysh gjatë punës sonë në komision në shqyrtimin e projektligjit.

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA